

VENDIM
Nr. 142, datë 22.11.2013

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “GJOKA KONSTRUKSION -
ENERGJI” SHPK NGA HEC-ET “LENIE”, “SHALES” DHE “STRELCË”**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9, pikat 1 dhe 2, germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 22.11.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjoka Konstruktion - Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC-et “Lenie”, “Shales” dhe “Strelcë”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Gjoka Konstruktion - Energji” sh.p.k. është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Gjoka Konstruktion - Energji” sh.p.k., nga HEC-et “Lenie”, “Shales” dhe “Strelcë”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti